



Dy dite pas humbjes dhe pasi kane pare veprimet e gabuara te gjyqtarit Lorenc Jemini, klubi Tiranes ka dale ne nje deklarate per mediat te cilen ja ka drejtuar presidentit te FSHF-se Armando Duka.

I nderuar Z. President!

Po ju drejtohem i permes kesaj letre te hapur, duke shprehur qendrimin tone qofte ne rruge institucionale, qofte ne rruge publike, ne lidhje me te gjitha ato fenomone te ndodhura ne menyre te perseritur ndaj interesave te Klubit te Furbollit Tirana. Paraprakisht, po Ju rikujtojme se ne filozofine dhe ADN – ne e klubit tone nuk ka vend per qendrimet viktimiste. Jemi pertej ketyre pozicionimeve disfatiste. Ne letren e hapur drejtuar numrit nje te qeverise se futbollit Armando Duka, klubi Tiranes nis procesin ndaj gjyqtareve, duke nisur nga sfida me Skenderbeun, per te vijuar me ate ndaj Kastriotit, dhe ne fund derbi me Partizanin. Ndashja e se shtunes vertetoi dhe konfirmoi edhe nje here se keto nuk jane episode te izoluara apo gabime njerezore, por pjese e nje plani te pergjithshem per demtimin e interesave te Klubit te Futbollit Tiranes. Pare gjykimi ne teresi dhe rast pas rasti, ne mendojme se arbitri ka influencuar drejtperdrejte negativisht ne rezultatin e ndeshjes. Mosdhenia e kartonave ndaj lojtareve te Partizanit, dhenia e kartonave pa arsye ndaj lojtareve te Tiranes si dhe mosakordimi i 3 11-metershave, jane tregues se Lorenc Jemini ishte tendencioz ndaj ekipit te Tiranes, gje e cila, tregon hapur se gjithcka po ndodh. Ky skenar i parapregatitur eshte produkt jo individual, por institucional, shumeperfshires dhe ne rrethanen e bashkepunimit ndermjet te gjitha subjekteve pjesemarrese... Federate, organet dhe individet nen varesi, Klube etj. Nuk do te qendrojme pasiv ndaj trajtimeve preferenciale te bera ne favor te kujtdo. Kemi qene gjithnje perkrahes se futbollit te paster; perkrahes te mundit dhe cilesise se treguar ne fushen e lojes; perkrahes te sportivitet dhe lojes se ndershme. Nuk duam t'ju rikujtojme padrejtesise absurde qe i jane bere ne te shkuare Tiranes. Ju kerkojme veç profesionalizem, seriozitet dhe ligjshmeri. Kekojme te respektohen dhe te zbatohet perpikmerisht i gjithe legjislacioni futbollistik i miratuar nga Federata Shqiptare e Futbollit. Kerkojme qe ne futbollin e diteve te sotme te marrin pjese vetem subjekte me integritet. Kerkojme drejtesi brenda dhe jashte fushes se lojes”, thuhej ne deklaraten e Tiranes.

## Tirana/ Klubi leter FSHF-se, akuza per komplot

nga AlbaniaSoccer

E hënë, 14 Tetor 2013 14:12

---